

VENDIM
Nr.703, datë 16.7.2008

PËR MOSRINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR
“TV BUTRINTI”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Mesila Doda (Demi)	Kryetare
Frano Kulli	Zvendëskryetar
Artan Zeneli	Anëtar
Detar Hysi	Anëtar
Alban Karapici	Anëtar
Gent Ibrahim	Anëtar
Sami Neza	Anëtar

Pasi mori në shqyrtim çështjen me:

Objekti: Për shqyrtimin e kërkesës për rinovim licence të paraqitur nga subjekti televiziv privat kabllor “TV Butrinti”.

Baza ligjore: Neni 7 pika 21, neni 25 i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullorja “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë rtv” të KKRT-së, ligji nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe vendimit nr.624, datë 1.10.2007 të KKRT-së “Mbi vlefshmërinë e licencës së disa subjekteve radiotelevizivë privatë”.

VËREN SE:

Mbështetur në vendimin nr.624, datë 1.10.2007 të KKRT-së “Mbi vlefshmërinë e licencës së disa subjekteve radiotelevizivë privatë”, subjekti televiziv privat kabllor “TV Butrinti” nuk u rilicencua, sepse nuk kishte shfaqur interes për rinovimin e licencës. Sipas pikës dy të vendimit ky subjekt kishte të drejtë që brenda 30 ditëve të parashtronte pretendimet e tij lidhur me këtë vendim. Në mbledhjen e datës 18.12.2007, KKRT, pasi dëgjoi pretendimet e subjektit, ra dakord që ky subjekt të paraqiste dokumentacionin përkatës për rinovimin e licencës brenda datës 31.1.2008. Në datën 31.1.2008, subjekti “TV Butrinti” ka depozituar dokumentacionin përkatës për rilicencim me nr.105 prot.

Nga shqyrtimi tërësor i dokumentacionit për rinovimin e licencës, rezultoi se, subjekti “TV Butrinti”:

- Nuk ka paraqitur për lejen për rrjetin kabllor.

Nga sa më sipër, rezulton se nuk mund të rinovohet licenca për televizionin privat kabllor “TV Butrinti”.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë rtv”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së, si dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

VENDOSI:

1. Nuk rinovohet licenca për subjektin televiziv privat kabllor “TV Butrinti” dhe licenca me nr.004/RTV kabllor bëhet e pavlefshme.
2. Subjekti “TV Butrinti” është i detyruar të ndërpresë menjëherë transmetimin.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda një muaji në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)